

**draft**

Në bazë të nenit 41 të Ligjit për organizatat turistike ("Fl. zyr. RMZ", nr. 11/04, 46/07, "Fl. zyr. MZ", nr. 73/10, 40/11, 45/140 dhe 27/19, ("Fl. zyr. MZ", nr. 1/11, 6/11, 39/11 dhe 32/14) nenit 58 paragrafi 1 pika 2 dhe 8 si dhe nenit 63 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 5/2007, 9/2009, 16/2011 dhe 48/2019), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më \_\_\_\_ . 2020 nxjerrë

**VENDIMIN**

**për lartësinë, mënyrën e llogaritjes dhe pagesës së kontributit të anëtarësisë Organizatës Turistike të Ulqinit**

**Neni 1**

Me këtë Vendim caktohet lartësia, mënyra e llogaritjes dhe pagesës së kontributit të cilin e paguajnë të gjithë personat juridikë, personat fizikë dhe sipërmarrësit, përkatësisht shoqëritë që ushtrojnë veprimtari

Subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni janë të detyruar t'i raportojnë organit kompetent tatimor të komunës në territorin e të cilit ata operojnë dhe të raportojnë të ardhurat e realizuara të biznesit, të zvogëluara për shumën e shpenzimeve afariste, individualisht për secilën njësi organizative në të cilën kryhen aktivitetet e turizmit, hotelierisë dhe/ose veprimtari që ka lidhje direkte me turizmin.

**Neni 2**

Elementet themelore për caktimin e lartësisë së kontributit të anëtarësisë janë:

- grupet e veprimtarive dhe
- shuma e të ardhurave afariste që e realizon anëtari në vitin para vitit për të cilin caktohet kontributi i anëtarësisë i zvogëluar për shumën e shpenzimeve afariste.

Shuma e kontributit vjetor të llogaritur të anëtarësisë nga paragrafi 1 i këtij neni zvogëlohet për vendet e kategorisë B me 50 %, kategorisë C dhe D me 70 %.

**Neni 3**

Lartësia e kontributit të anëtarësisë për veprimtaritë të cilat janë të klasifikuar me Rregulloren për klasifikimin e veprimtarive për të cilat paguhet kontributi i anëtarësisë organizatave turistike ("Fl. zyr. MZ", nr. 36/13) përcaktohet në shumat si vijon:

<b>Shuma vjetore e të ardhurave (€)</b>	<b>Shuma vjetore e kontributit të anëtarësisë (€)</b>				
	<b>Grupi I</b>	<b>Grupi II</b>	<b>Grupi III</b>	<b>Grupi IV</b>	<b>Grupi V</b>
<b>1 - 5 000</b>	90	80	70	60	50
<b>5 001 - 10 000</b>	120	100	80	70	60
<b>10 001 - 20 000</b>	180	140	100	80	70
<b>20 001 - 50 000</b>	360	280	240	160	100
<b>50 001 - 120 000</b>	540	420	340	220	160
<b>120 001 - 250 000</b>	1250	1050	750	460	240
<b>250 001 - 500 000</b>	2960	2340	1720	1100	480
<b>500 001 - 1 000 000</b>	5190	3970	2750	1530	720
<b>Preko 1 000 001</b>	7020	5040	4020	2520	960

#### **Neni 4**

Kontributin e anëtarësisë nga neni 3 i këtij Vendimi obliguesi e paguan në këste 12 mujore, të cilët për muajin aktual arrijnë 10 para përfundimit të muajit paraprak.

Në rastin kur obliguesi fillon ose pushon të ushtrojë veprimtarinë gjatë vitit, i nënshtrohet pagesës së obligimit nga neni 1 i këtij Vendimi sipas volumit të realizuar të të ardhurave, të zvogëluara për shumën e shpenzimeve afariste.

#### **Neni 5**

Ngarkimi me kontributin e anëtarësisë përcaktohet me aktvendim të organit kompetent për punën e ardhurave lokale publike.

Organi nga paragrafi 1 i këtij neni mbikëqyr caktimin, llogaritjen dhe pagimin e kontributit të anëtarësisë.

#### **Neni 6**

Obliguesi i kontributit të anëtarësisë paguan:

- 60 % të kontributit të anëtarësisë Organizatës turistike Ulqin dhe
- 40 % të kontributit të anëtarësisë Organizatës kombëtare turistike.

#### **Neni 7**

Obliguesi i kontributit të anëtarësisë është i obliguar që deri, më 30 prill të vitit në vijim organit nga neni 5 paragrafi 1 të këtij Vendimi, t'i paraqesë të ardhurat e realizuara afariste të zvogëluar për shumën e shpenzimeve afariste për vitin paraprak, të pasqyruara individualisht për secilën njësi organizative në të cilën ushtorn veprimtarinë.

#### **Neni 8**

Në raportet që nuk janë rregulluar veçmas në këtë Vendim, e që kanë të bëjnë me pagimin e kontributit të anëtarësisë aplikohet Ligji me të cilin rregullohet procedura tatimore.

#### **Neni 9**

Me gjobë në të holla prej 500,00 € deri në 20.000.00 € do të gjobitet për shkelje personi juridik nëse nuk paguan kontributin e anëtarësisë në afatin dhe lartësinë e parashikuar.

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjëgjës në personin juridik me gjobë në shumën prej 250€ deri në 500€.

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni sipërmarrësi do të dënohet e gjobë në shumën prej 250€ deri në 6000 €.

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi fizik me gjobë në shumën prej 250€ deri në 2000 €.

#### **Neni 10**

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushon Vendimi për lartësinë, mënyrën dhe përlllogaritjen dhe pagesën e kontributit të anëtarësisë Organizatës turistike të Ulqinit ("Fl. zyr. RMZ – dispozitat e komunës", nr. 35/2016 të datës 05.08.2016).

**Neni 11**

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në “Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës”.

Numër:

Ulqin, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2020

**KUVENDI I KOMUNËS  
KRYETARI I KUVENDIT  
Ilir Çapuni**

Me vendim të Kuvendit të Komunës të Ulqinit të datës 11.05.2020, të cilin është miratuar dhe aprovuar Programi i punëve të përgjithshme të Komunës të Ulqinit për vitin 2020.

Me vendim të Kuvendit të Komunës të Ulqinit të datës 11.05.2020, të cilin është miratuar dhe aprovuar Programi i punëve të përgjithshme të Komunës të Ulqinit për vitin 2020, të cilin është miratuar dhe aprovuar Programi i punëve të përgjithshme të Komunës të Ulqinit për vitin 2020.

Me vendim të Kuvendit të Komunës të Ulqinit të datës 11.05.2020, të cilin është miratuar dhe aprovuar Programi i punëve të përgjithshme të Komunës të Ulqinit për vitin 2020.

Me vendim të Kuvendit të Komunës të Ulqinit të datës 11.05.2020, të cilin është miratuar dhe aprovuar Programi i punëve të përgjithshme të Komunës të Ulqinit për vitin 2020.

Me vendim të Kuvendit të Komunës të Ulqinit të datës 11.05.2020, të cilin është miratuar dhe aprovuar Programi i punëve të përgjithshme të Komunës të Ulqinit për vitin 2020.

Me vendim të Kuvendit të Komunës të Ulqinit të datës 11.05.2020, të cilin është miratuar dhe aprovuar Programi i punëve të përgjithshme të Komunës të Ulqinit për vitin 2020.

Me vendim të Kuvendit të Komunës të Ulqinit të datës 11.05.2020, të cilin është miratuar dhe aprovuar Programi i punëve të përgjithshme të Komunës të Ulqinit për vitin 2020.

Me vendim të Kuvendit të Komunës të Ulqinit të datës 11.05.2020, të cilin është miratuar dhe aprovuar Programi i punëve të përgjithshme të Komunës të Ulqinit për vitin 2020.

Me vendim të Kuvendit të Komunës të Ulqinit të datës 11.05.2020, të cilin është miratuar dhe aprovuar Programi i punëve të përgjithshme të Komunës të Ulqinit për vitin 2020.

Me vendim të Kuvendit të Komunës të Ulqinit të datës 11.05.2020, të cilin është miratuar dhe aprovuar Programi i punëve të përgjithshme të Komunës të Ulqinit për vitin 2020.

Ilir Çapuni

## ARSYETIM

**BAZA JURIDIKE:** Bazën juridike për nxjerrjen e këtij Vendimi e përmbajnë dispozitat Ligjit për organizatat turistike ("Fletorja zyrtare e RMZ", nr. 11/04 dhe 46/07 dhe "Fletorja zyrtare e MZ", nr. 73/10, 40/11, 45/14, 27/17 dhe 27/19) dhe Statuti i Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 48/19).

Neni 41 i Ligjit për organizatat turistike parashikon që mbikëqyrjen për përcaktimin, llogaritjen dhe pagimin e kontributit të anëtarësisë e bënë organi kompetent tatimor i Komunës.

Neni 58, paragrafi 1, pika 8 i Statutit të Komunës së Ulqinit parashikon që Kuvendi futën dhe përcakton tatimet, taksat, kompensimet dhe të ardhurat e tjera të komunës, kurse neni 63 parashikon aktet të cilët i nxjerr Kuvendi në kryerjen e punëve nga fushëveprimi i vet.

**ARSYET PËR NXJERRJEN E VENDIMIT:** Kuvendi i Malit të Zi, më 04 prill 2019 ka nxjerrë Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për organizatat turistike. Me nenin 37 të Ligjit ka ardhur deri tek ndryshimi në atë mënyrë që subjektet të cilët paguajnë kontributin e anëtarësisë janë të detyruar që organit kompetent të komunës në territorin e të cilës afarizojnë, t'i pasqyrojnë dhe paraqesin të ardhurat e realizuara afariste të zvogëluara për shumën e shpenzimeve afariste.

Për sa u tha, i propozohet Kuvendit të Komunës së Ulqinit të nxjerrë Vendimin për lartësinë, mënyrën e llogaritjes dhe pagesës së kontributit të anëtarësisë në Organizatën turistike të Komunës së Ulqinit.

**PËRMBAJTJA E VENDIMIT:** Me këtë Vendim është propozuar caktimi i lartësisë, mënyrës së llogaritjes dhe pagesës së kontributit të anëtarësisë që e paguajnë personat juridikë, personat fizikë dhe sipërmarrësit, përkatësisht shoqëritë që ushtrojnë veprimtari turistike, hoteliere dhe/apo veprimtari që kanë lidhje direkte me turizëm, të cilët e kanë selinë e vet ose njësinë organizative e kanë në territorin e Komunës së Ulqinit.

Elementet themelorë për caktimin e lartësisë së kontributit të anëtarësisë varen nga grupi i veprimtarisë dhe shuma e të ardhurave afariste që i realizon anëtari në vitin para vitit për të cilin përcaktohet kontributi i anëtarësisë i zvogëluar për shumën e shpenzimeve afariste, kështu që lartësia vjetore e kontributit të anëtarësisë së llogaritur zvogëlohet për vendet e kategorisë B për 50 %, kurse për vendet e kategorive C dhe D për 70 %, në pajtim me kategorizimin e vendeve turistike.

Lartësia e kontributit vjetor të anëtarësisë varet nga grupi i veprimtarisë, që përcaktohet me Rregulloren për klasifikimin e veprimtarive për të cilat paguhen kontributet e anëtarësisë në organizatat turistike ("Fl. zyr. MZ", nr. 36/13) dhe nuk mund të jetë më pak se 50,00 €, e as më shumë se 10.000,00 €.

Kontributin e anëtarësisë tatimpaguesi e paguan në 12 këste mujore, të cilët për muajin aktual arrijnë 10 para përfundimit të muajit paraprak, e në rast që tatimpaguesi fillon ose pushon të ushtrojë veprimtarinë gjatë vitit, i nënshtrohet pagesës së obligimeve sipas volumit të realizuar të të ardhurave i zvogëluar për shumën e shpenzimeve afariste.

Mjetet e mbledhura që i paguan tatimpaguesi në bazë të kontributit të anëtarësisë paguhen 60 % për Organizatën turistike të Komunës së Ulqinit dhe 40 % për Organizatën kombëtare turistike.

Ngarkimi me kontributin e anëtarësisë përcaktohet me aktvendim të organit kompetent për çështje të të ardhurave publike dhe po ai bënë edhe mbilëqyrjen e caktimit, llogaritjes dhe pagimit të kontributit të anëtarësisë.

Në raportet që nuk janë rregulluar veçmas në këtë Vendim, e që kanë të bëjnë me pagimin e kontributit të anëtarësisë aplikohet Ligji me të cilin rregullohet procedura tatimore.

Sekretariati për buxhet dhe finansa